



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 18/02/ 2019	Numri i seancës për këtë çështje:
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
<b>A. Informacioni bazë</b>			
Institucioni dhe tema:	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit		
Emri i subjektit të rivlerësimit	Dritan Peka		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Drejtuës i Prokurorisë së Apelit të Tiranës		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Në përfundim të seancës dëgjimore, e cila filloi në orën 14.00 dhe mbaroi në orën 15.48 minuta, trupi gjykues vendosi shtyrjen e seancës.		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Vendimi nuk u shpall në përfundim të seancës. Trupi gjykues e shtyu dhënien e vendimit, ndaj Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit të Tiranës, për në datën 21 shkurt, por pa dhënë ndonjë arsye. Konstatohet se së fundmi, pjesa më e madhe e vendimeve, nuk jepet në fund të seancës dëgjimore, por shtyhet për dy apo tre ditë me vonë.		
<b>B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca</b>			
Trupa gjykuese (emrat)	Roland Ilija (Kryetar); Olsi Komici (anëtar); Lulzim Hamitaj (relator)		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Elka Ermenkova		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Subjekti u asistua nga avokati, Besnik Çerekja		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Dafina Zeneli		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Seancën e ndoqën rreth 20 persona, mes te cilëve: Avokatja e Popullit, qytetare, vëzhgues		
Media e pranishme:	Ishin të pranishëm gazetarë dhe operatore të disa televizioneve dhe portaleve.		
<b>C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?</b>	<b>Po</b>	<b>Nëse po, si u justifikua ai?</b>	<b>Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?</b>
	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendosi të kryejë vlerësimin për të treja kriteret: pasuror, moral dhe profesional.		

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	Kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	Lidhur me këtë kriter, relatori i çështjes paraqiti rezultatet e vlerësimit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. ILDKPI konkludon në raport, se subjekti ka kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin, ka pasur burime të ligjshme, nuk ka bërë deklarim të rremë dhe nuk ka konflikt interesi.	ILDKPI	Relatori i çështjes u shpreh se KPK i ka kaluar subjektit barrën e provës mbi dyshimet e ngritura për kontrata fiktive, përfitim jo në përmbushje të dispozitave ligjore të një kredie të butë prej 5 milion lekësh për strehim, si dhe blerjen e një makine tip BMW me çmim fiktiv. Nga ana e tij subjekti pretendoi se Kredia e butë është marrë në përputhje me ligjin. Ai theksoi se bashkëshortja nuk ka aplikuar si e pastrehë, por për strehim si zyrtar, mbështetur në ligjet në fuqi asokohe. "Pronësia e ¼ së apartamentit të prindërve nuk mund të konsiderohet si banesë strehimi për familjen. Ndërkohë që për apartamentin tjetër kam qenë porositës, por nuk kemi qenë pronarë. Në lidhje me automjetin, që pak ditë pas blerjes në Gjermani nga shtetasi S.M (në total me zhdoganim në vlerën e 2 379 000 lekëve) subjekti u shpreh se ishte me defekt, riparimi i të cilit shkonte rreth 5 mijë euro, dhe ndaj e ka blerë në vlerën e 980 mijë lekëve. Subjekti i rivlerësimit e ka cilësuar jo real këtë konstatim. Pretendimet e subjektit, do shqyrtohen me objektivitet, u shpreh relatori.
	Pasuria familjare, 2003-2017, llogaritet në 34.5 milionë lekë <ul style="list-style-type: none"> <li>Burim i të ardhurave, paga e subjektit dhe e bashkëshortes</li> </ul> Pasuria familjare në fund të vitit 2017 <ul style="list-style-type: none"> <li>Apartament në Tiranë, me sip. 96.4 m2, me vlerë 5.2 milionë lekë</li> <li>Apartament në Orikum, me sip. 59 m2, me vlerë 20 mijë euro</li> <li>1/4 e një apartamenti në Tiranë, me sip. 71 m2, privatizuar nga familja e tij në vitin 1993, me vlerën e 10 047 lekëve</li> <li>Një automjet tip BMW, në vlerën e 980 mijë lekëve</li> </ul>	ILDKPI	
	KPK ka kryer një hetim të pavarur administrativ lidhur me pasurinën e prokurorit Dritan Peka. KPK konkludoi se subjekti Peka nuk ka pasur mundësi paguese dhe ka mos përputhje të deklarimeve të tij me ato të administratorëve të shoqërisë që ka kryer shitjen. Relatori Hamitaj u shpreh se janë gjetur mospërputhje me datat e mandat-pagesave për blerjen e apartamentit në Tiranë. Po ashtu kredia shtetërore e marrë në vitin 2010, për blerjen e një apartamenti 100 m2 në Tiranë, pas revokimit të kontratës me sipërmarrësin, është përdorur në mospërputhje me ligjin, për blerjen e një apartamenti në Orikum si edhe për mobilimin e shtëpisë në Tiranë, ku familja jetonte prej vitesh. Subjekti ka të pajustifikuar me dokumentacion edhe një hua prej 15 mijë eurosh, marrë nga shoku i tij që jeton në SHBA. Peka ka vënë në dispozicion një deklaratë të noterizuar në SHBA, por tha gjatë seancës, se nuk zotëronte dokumentacion tjetër për këtë hua. KPK ka konstatuar mungesë dokumentacioni edhe për pagesën e makinës tip BMW, duke ngritur dyshimet për fiktivitet lidhur me çmimin e blerjes. Makina rezultoi të jetë blerë në Gjermani më 28 nëntor 2013 nga shtetasi S.M. me vlerë totale 2 379 000 lekë, dhe i është shitur subjektit pak ditë më vonë në vlerën e 980 mijë lekëve. Relatori Hamitaj pohoi se për diferencën, prokurori dhe shtetasi S.M. kanë deklaruar se mjeti ishte blerë me defekt në Gjermani, ndaj i është bere zbritja për ta riparuar. Mungesë dokumentacioni është gjetur edhe për justifikimin e shpenzimeve të kryera nga subjekti gjatë viteve 2005, 2006 dhe 2009.	KPK	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës, si edhe ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. DSIK ka konkluduar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Dritan Peka.	DSIK	
	Edhe KPK vlerëson se subjekti është në përshtatshmëri për vijimin e detyrës, se nuk është i përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, apo për lidhje dhe kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.	KPK	

D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Në raportin e dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, lidhur me aftësitë profesionale të subjektit, rezultoi se janë përfshirë edhe ankesat e disa shtetasve për mos ushtrim rekursi në Gjykatën e Lartë. Grupi i punës së Prokurorisë së Përgjithshme ka dalë në konkluzionin se drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Tiranë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin duke mos ushtruar rekurs.	Prokuroria e Përgjithshme	Por nga ana e tij subjekti është shprehur se është e pamundur dhe nuk është detyrë e tij të verifikojë afatet e rekursit. Peka theksoi se 20 mijë çështje janë menaxhuar prej tij gjatë këtyre viteve, përveç atyre që ka përfaqësuar. Lidhur me rastin konkret, subjekti i mbështetur edhe avokati, u shprehen se prokurori i çështjes e ka njoftuar me shkrim, se do të bënte rekurs dhe se drejtuesi i prokurorisë, nuk mund të fokusohet vetëm tek një çështje, nisur edhe nga ngarkesa e institucionit që ai drejton. Pyetjes së relatorit, se çfarë mase ka marrë ndaj prokurorit të çështjes, kur ka konstatuar moszbatimin e detyrës për rekurs; subjekti tha se nuk fillohet procedim disiplinor vetëm për një çështje. Në fund subjekti kundërshtoi konkluzionet e raportit lidhur me kriterin pasuror dhe atë profesional, si edhe kërkoi konfirmimin në detyrë. Pretendimet e subjektit, sipas relatorit, do shqyrtohen me objektivitet.
	KPK në përfundim të hetimit të kryer për aspektin profesional, ka konkluduar se ka mangësi në aftësitë drejtuese dhe menaxheriale. Më konkretisht KPK, beri me dije se janë depozituar 4 ankesa nga qytetaret. Një prej tyre e akuzon subjektin, për qëndrim të njëanshëm dhe paaftësi duke mos ushtruar rekurs. KPK vlerëson se nuk janë kryer veprime nga prokurori i çështjes dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Tiranë. Një hapësirë të konsiderueshme, ka zënë edhe një denoncim i mbërritur pranë ONM-së, ku pretendohet për shkelje në emërimin e një punonjësi të administratës së Prokurorisë së Apelit Tiranë, ( A.M ) por edhe pagesë të tij për tre muaj në mungesë të paraqitjes në vendin e punës. Relatori tha se kancelarja e Prokurorisë së Apelit Tiranë është shprehur para komisionit se i është kërkuar verbalisht nga subjekti që të kryejë pagesën e specialistit në mungesë, por se ajo ka refuzuar. Subjekti refuzoi të këtë dhënë urdhër verbal, për më tepër u shpreh se specialisti gjatë asaj kohe ka qënë në punë, çka e provojnë sipas tij dokumentet e firmosur për marrjen e materialeve në magazinë. Po ashtu komisioni bën me dije se ka konstatuar në disa raste deklarata kontradiktore të Pekës. Sipas KPK-së në këtë rast subjekti, jo vetëm nuk ka marrë masat për personin përgjegjës, por ka dyshime për urdhër verbal prej tij.	KPK	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	Seanca e rivlerësimit për subjektin Dritan Peka, zgjati për një orë e 48 minuta. Realizimi i saj rezultoi në përmbushje të kushteve për një proces të rregullt ligjor. Subjektit të rivlerësimit i është dhënë akses tek dokumentet gjyqësore dhe parashtratat me shkrim të dokumenteve. Ai ishte njoftuar me datën 4 shkurt 2019 nga KPK për përfundimin e hetimit dhe i ishte vënë në dispozicion dosja me dokumentet përkatëse. Subjekti konfirmoi që ishte njohur me raportet e hetimit dhe kishte paraqitur pretendimet e tij, duke kundërshtuar gjetjet për kriterin pasuror dhe atë profesional. Nga trupi gjyqësor nuk është vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës. Subjekti nuk është trajtuar në mënyrë paragjyqëse nga trupi gjyqësor. Megjithatë një nga pyetjet e relatorit Hamitaj, nëse subjekti kishte konstatuar prezencën fizikisht të specialistit A.M, gjatë periudhës, për të cilën pretendohet nga kancelarja mungesa e tij, u cilësua e pavend nga ana e avokatit mbrojtës. Nga vëzhguesja ndërkombëtare nuk pati pyetje apo komente. U respektua parimi i konfidencialitetit në komunikimin mes subjektit dhe avokatit. Sa i përket parimit të publicitetit të gjykimit, rezultoi se është respektuar. Data, vendi, dhe ora e zhvillimit të seancës dëgjimore u njoftuan paraprakisht, në faqen zyrtare të KPK-së. Seanca ishte e hapur për këdo të interesuar, pasi shënonte gjeneralitetet në hyrje të sallës. Mediat kishin hapësirën e nevojshme, për ndjekjen e seancës. Bazuar në rregulloren e KPK-së, kamerat u lejuan të xhironin vetëm gjatë hapjes së seancës, ndërsa më pas ajo mund të ndiqej vetëm nga gazetarët, që u lejuan të komunikonin përmes sms-ve me redaksitë. Në përfundim të hetimeve lidhur me subjektin Peka, KPK konstatoi probleme në kriterin pasuror dhe atë profesional. Nga ana e tij subjekti i rivlerësimit, me një karrierë profesionale 22 vjeçare, kundërshtoi gjetjet dhe kërkoi konfirmimin në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit të Tiranës.		